VENDIM
Nr. 271, datë 19.9.2023

MBI RINOVIMIN E LICENCËS SË SHOQËRISË "KORPORATA ELEKTROENERGJETIKE SHQIPTARE" (KESH) SHA, NË VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa "ç", të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; neneve 4, pika 1, germa "d", 5, pika 1, germa "d", 13 dhe 16 të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe nenit 15 të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 19.9.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1796/6 prot., datë 14.9.2023, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, "Mbi rinovimin e licencës së shoqërisë 'Korporata Elektroenergjetike Shqiptare' (KESH) sh.a., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike",

konstatoi se:

- Shoqëria "Korporata elektroenergjetike shqiptare" (KESH) sh.a., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1796/1 prot., datë 18.8.2023, aplikoi për rinovimin e licencës në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike dhe me vendimin nr. 262, datë 31.8.2023, Bordi i ERE-s vendosi të fillojë procedurën për kërkesën e protokolluar në ERE.
- ERE botoi njoftimin në medien e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 1.9.2023 dhe 2.9.2023) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo të objeksioneve nga të tretët (data 10.9.2023), nuk rezultoi të ketë të tilla. Ky njoftim u publikua dhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.
- Me shkresën nr. 1796/5 prot., datë 4.9.2023, ERE iu drejtua shoqërisë duke i njoftuar vendimin për fillimin e procedurës së licencimit.
- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit në zbatim të përcaktimeve të aneksit A të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, si dhe ka shlyer ndaj ERE-s të gjitha detyrimet për sa i përket pagesave të rregullimit.
- Dokumentacioni i këtij aplikimi rezulton tërësisht i plotësuar.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të rinovojë licencën nr. 437, seria F19, të shoqërisë "Korporata Elektroenergjetike Shqiptare" (KESH) sh.a., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar, duke filluar nga data 29.2.2024.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi, apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti